



NUMERI: 02-442/5
Data / Datë: 06.06.2023
Shënimtja, Podreci / Annex:

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.10/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore të cilin me autorizim e përfaqësojnë, që të dy avokat nga Prishtinë, lidhur me veprimet përmbardimore të lëndët përmbardimore, P.nr.340/2022 deri të P nr.512/2022, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat Burbuqe Spahiu - Kërveshi, nga Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira Albulena Uka, Përmbarduesi Privat me përfaqësuesit e tij të autorizuar, me datën 01.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-10/2023 i datës 24.03.2023, lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarduesit privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore, si i pabazuar.

II. Përmbarduesi Privat si organ përmbardues, nuk është përgjegjës për shkeljet të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndët përmbardimore nga P.nr.340/2022 deri te lënda, P nr.512/2022.

A r s y e t i m

Pretendimet e inicuesit të Procedurës disiplinore.

Departamenti për Profesione të Lira – Divizioni për Noteri dhe Përmbardim Privat, me datë 21.03.2023, iniciues i kësaj procedure disiplinore nga Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira Petrit Reçica, për kryerjen e inspektimit të veçantë

për sa i përket punës së Përmbauesit Privat që është palë në këtë procedurë, me nr.03/2022 të datës 04.10.2022. Iniciuesi i procedurës si në raport, në kërkesë në fillimin e procedurës disiplinore, ashtu edhe në seancën dëgjimore përmes përfaqësueses, kanë pretenduar se përmbauesi privat lëndore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbaimore nga rasti P.nr.340/2022 deri të P nr.512/2022, e ka lejuar përmbaimin në bazë të dokumenteve – vendimeve të Inspektoratit të Punës, e që nuk është kompetencë e përmbauesit privat që të bënë ekzekutimin e rasteve që kanë të bëjnë me kontestet e punës pasi që kjo është në kompetencë të gjykatës. Në këtë rast inicusesi i procedurës pretendon se përmbauesi lëndor ka rënë në kundërshtim me Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin janë definuar në mënyrë specifike se kontestet nga marrëdhënia e punës janë në kompetencë të gjykatës. Mbi këtë bazë iniciuesi i procedurës ka kërkuar nga komisioni që përmbauesit privat ti shqiptohet masa disiplinore në proporcion me shkeljen e që do të vlerësohet nga komisioni.

Pretendimet e Përmbauesit Privat, palë në këtë procedurë

Përmbauesi Privat, si në përgjigje në me rastin e inicimit të procedurës disiplinore, ashtu në seancë dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësuesve të tij, e ka kundërshtuar në tërësi raportin për inicimin e procedurës disiplinore, se në kundërshtim me udhëzuesin e Gjykatës Supreme, ka ndërmarr veprime nga në lëndët përmbaimore P.nr.340/2022 e deri të P.512/2022, ngase praktike e përmbauesve privat deri me tani është e krijuar në vendin tonë ashtu siç ka vepruar edhe përmbauesi privat ku janë mija raste që është vepruar në mënyrën e njëjtë dhe për më tepër përmbauesi pretendon se ka vepruar në tërësi në harmoni më Ligjin e Procedurës Përmbaimore, duke e lejuar përmbaimin në bazë të dokumentit të përmbaueshëm me titull ekzekutiv. Nga këto arsye të dhëna përmbauesi privat ka kërkuar nga komisioni që të refuzohet si i pabazuar kërkesa e iniciuesit të procedurës disiplinore.

Baza ligjore që një përmbaues privat mund të bëjë shkelje disiplinore

Neni 367 paragrafi 1 pikat nga 1 deri 11, i Ligjit të Procedurës Përmbaimore, i përcakton shkeljet përmbaimore për përmbauesit privat, si janë në vijim:

- 1.1. Nëse përmbauesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj;
- 1.2. Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbauesi privat nuk i përmbahet ligjit;
- 1.3. Nëse përmbauesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;
- 1.4. Nëse përmbauesi privat ka shkelur detyrat e parashikuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr;

- 1.5. Nëse përmbartuesi privat ndërmer veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;
- 1.6. Nëse përmbartuesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;
- 1.7. Nëse përmbartuesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;
- 1.8. Nëse përmbartuesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;
- 1.9. Nëse përmbartuesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbartimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;
- 1.10. Shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera dhe
- 1.11. Nëse përmbartuesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit Disiplinor për Përmbartues Privat

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, analizimit të dispozitës së lart cituar, Komisioni Disiplinor, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që Përmbartuesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore, për këto arsye:

Në këtë rast nuk është kontestuese se në mes te palëve në procedurë dhe për komisionin disiplinor, se Departamenti për Profesione të Lira – Divizioni për Noteri dhe Përmbartim Privat, për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira, për Përmbartuesit Privat nga Ministria e Drejtësisë, ka bërë inspektimin të veçantë te punës tek përmbartuesi lëndorë pas pranimit të parashtrësës së Drejtorit të Thesarit të Republikës së Kosovës, me datën e paraqitur në raport, për këtë çështje juridike, nuk është kontestues se përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues – vendimit përmbartues i dhënë në procedurë administrative nga Inspektorati i Punës.

Kontestuese mbetet në këtë rast, se a kemi të bëjmë me shkelje disiplinore, pasi që përmbartuesi privat nuk iu ka përmbajtur kompetencës lëndore sipas Udhëzuesit të Gjykatës Supreme, të vitit 2021, në rastet e përmbartimit ku kemi të bëjmë me konteste të punës.

Komisioni Disiplinor vlerëson se në këtë rast, pas analizimit të dispozitës së lartcekur ligjore, ndarjen e çështjeve jo kontestuese dhe atyre kontestuese si më lart, kemi të bëjmë ekskluzivisht me vlerësimin e kompetencës lëndore të lejitimit të përmbartimit nga përmbartuesi privat lëndor. Pra në rastin konkret, nuk është në kompetencën e komisionit disiplinor, që të vlerësoi kompetencën lëndore të përmbartuesit privat, sepse siç dihet dhe siç është e përcaktuar me LPP, ligjshmëria e lejitimit të përmbartimit të përmbartuesit, i nënshtrohet ligjshmërisë sipas prapësimit në gjykatë konform nenit 71, paragrafi 1, nën paragrafi 1.12 të LPP-së. Andaj , komisioni në këtë procedurë

e ka vlerësuar çështjen vetëm të kërkesës për çështje disiplinore, që për komisionin përmbaruesi nuk është përgjegjës sepse nuk është lëshuar në ekzaminimin e kërkesës së inicuesit të kësaj procedure, pasi që rasti ka të bëjë me shkeljen eventuale të kompetencës lëndore, e që nuk është në juridiksioni e këtij komisioni që ta vlerëson ligjshmërinë e vendimit të përmbaruesit, ashtu siç u vlerësua më lart.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr.10/2023 datë 01.06.2023

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par. 5 të LPP-së.